



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2020 – Numri: 172

Tiranë – E hënë, 28 shtator 2020

PËRMBAJTJA

	Faqe
Dekret i Presidentit nr. 11739, datë 22.9.2020	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 12177
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 714, datë 10.9.2020	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 887, datë 24.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurës së përshpejtuar për hartimin dhe miratimin e planit të detyruar vendor, si dhe procedurës së miratimit të lejeve të zhvillimit/ndërtimit, në rastet e fatkeqësisë natyrore”..... 12177
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 737, datë 17.9.2020	Për përcaktimin e rregullave për administrimin e Fondit Kombëtar të Kujdesit të Trashëgimisë Kulturore Materiale..... 12179
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 747, datë 23.9.2020	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 595, datë 31.8.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit ‘Ndërtimi dhe sistemimi i rrugës ‘Gjykata–Akademia e Marinës’ + rruga ‘Duro Shaska’ deri tek 7 pallatet, Vlorë, faza I’”..... 12180
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 748, datë 23.9.2020	Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Ndërtimi i segmentit rrugor ‘Elbasan–Banjë, loti II’, Elbasan”..... 12181
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 749, datë 23.9.2020	Për një ndryshim në vendimin nr. 695, datë 31.7.2013, të Këshillit të Ministrave, “Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor ‘Zgjerimi i rrugës së Elbasanit (Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë–Unaza e Madhe e Tiranës)’”..... 12184
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 750, datë 23.9.2020	Për mbylljen e veprimtarisë së institucionit arsimor parauniversitar privat, Medreseja “Ali Korça”, Kavajë..... 12184
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 751, datë 23.9.2020	Për mbylljen e veprimtarisë së institucionit arsimor parauniversitar privat, “Kryqi i Nderuar”, Sukth, Durrës..... 12185

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 752, datë 23.9.2020	Për mbylljen e veprimtarisë së institucionit arsimor parauniversitar privat, Medreseja “Hafiz Abdullah Zëmlaku”, Korçë.....	12186
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 753, datë 23.9.2020	Për një shtesë në vendimin nr. 682, datë 29.7.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për përdorimin e fondeve publike për transportimin e punonjësve arsimorë që punojnë dhe të nxënësve që mësojnë jashtë vendbanimit”, të ndryshuar.....	12187
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 754, datë 23.9.2020	Për një ndryshim në vendimin nr. 371, datë 6.5.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për dhënie shpërblimi për personelin që shërben në institucionet e përkujdesjes shoqërore rezidenciale publike, që janë në përgjegjësi administrimi të Shërbimit Social Shtetëror dhe të bashkive”....	12187
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 755, datë 23.9.2020	Për rishpërndarje fondesh buxhetore, ndërmjet programeve të miratuara në buxhetin e vitit 2020, për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.....	12188
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 756, datë 23.9.2020	Për funksionimin e komisionit të përbashkët të Shqipërisë dhe Kosovës për miratimin e teksteve të përbashkëta për diasporën.....	12188
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 758, datë 23.9.2020	Për një ndryshim në vendimin nr. 587, datë 22.7.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për përdorimin e fondit të rindërtimit, për financimin e rindërtimit të njësive të banimit në ndërtesa (pallat), të dëmtuara, në zonat e shpallura për zhvillim të detyruar”.....	12189
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 759, datë 23.9.2020	Për një ndryshim në vendimin nr. 202, datë 5.3.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për përdorimin e fondit të rindërtimit, miratuar në buxhetin e vitit 2020, për financimin e rindërtimit të banesave individuale”, të ndryshuar.....	12189
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 761, datë 23.9.2020	Për një ndryshim në vendimin nr. 307, datë 16.4.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për përdorimin e fondit të rindërtimit, për financimin e rikonstruksionit dhe ndërtimit të infrastrukturës publike, në funksion të rindërtimit të banesave individuale dhe caktimin e Fondit Shqiptar të Zhvillimit si njësi zbatuese”, të ndryshuar.....	12190
Udhëzim i përbashkët i ministrit të Financave dhe Ekonomisë dhe i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 3/3, datë 8.9.2020	Për një ndryshim në udhëzimin nr. 3, datë 24.2.2020, “Për kriteret, procedurat dhe mënyrën e administrimit të fondit të programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural”, të ndryshuar.....	12191
Vendim i Këshillit të Lartë të Prokurorisë nr. 200, datë 23.9.2020	Për miratimin e rregullores “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë në pozicionin e drejtuesit në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm”.....	12191
Njoftim i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme nr. 11140, datë 24.9.2020	Mbi hyrjen në fuqi të marrëveshjes ndërkombëtare.....	12204

**DEKRET**

Nr. 11739, datë 22.9.2020

**PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, pika “c”, dhe të nenit 93, të Kushtetutës, si dhe nenit 9, pika 7, e nenit 20, të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998, “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar,

DEKRETOJ:**Neni 1**

U jepet shtetësia shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:

1. Halil Ajet Krasniqi
2. Shehide Selman Krasniqi (Selimi)
3. Avni Halil Krasniqi
4. Sadije Sadri Krasniqi (Azemi)
5. Afrim Halil Krasniqi
6. Kim Memet Memeti
7. Semi Kim Memeti
8. Emad Kim Memeti
9. Noli Rifat Çeku
10. Kushtrim Rifat Çeku
11. Donika Rifat Çeku Sylja (Çeku)
12. Fatmire Salatin Zogu Hasani (Zogu)
13. Arsim Fadil Ramadani
14. Agim Nuhi Velu
15. Igballe Hasan Velu (Fetahaj)
16. Agim Ali Elshani
17. Servete Riza Elshani (Shala)

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta**

VENDIM

Nr. 714, datë 10.9.2020

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA
NË VENDIMIN NR. 887, DATË 24.12.2019,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE DHE
TË PROCEDURËS SË PËRSHPEJTUAR
PËR HARTIMIN DHE MIRATIMIN E
PLANIT TË DETYRUAR VENDOR, SI
DHE PROCEDURËS SË MIRATIMIT TË
LEJEVE TË ZHVILLIMIT/NDËRTIMIT,
NË RASTET E FATKEQËSISË
NATYRORE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 19, pikat 3 e 8, 20, 21, pikat 3 e 5, 22, pika 4, 23, pika 4, 25, pika 2, dhe 34, pika 6, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë dhe të ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 887, datë 24.12.2019, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në kreun III bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Pika 3 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“3. Kriteret e zhvillimit përcaktohen në lejen e zhvillimit.”.

b) Pika 4 shfuqizohet.

c) Pika 5 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“5. Dokumentacioni që duhet të dorëzohet nga aplikuesi për pajisjen me leje zhvillimi është:

a) kërkesa për leje zhvillimi, sipas formatit të aplikimit në sistemin *e-leje*;

b) relacioni shpjegues mbi tipologjinë e zhvillimit të kërkuar;

c) dokumenti që vërteton të drejtat pasurore të pronës/ave që marrin pjesë në zhvillim ose vendim i këshillit bashkiak për miratimin e listës së përfituesve nga programet e procesit të rindërtimit për objektet në pronësi private apo bashkëpronësi, dhe në rastin e objekteve publike vendimi i këshillit bashkiak për prishjen dhe rindërtimin e asetit;



ç) plani i rilevimit të truallit që do të zhvillohet, hartuar nga inxhinierë gjeodetë të licencuar;

d) plani i vendosjes së strukturës që do të zhvillohet.”.

ç) Pas pikës 5 shtohet pika 6, me këtë përmbajtje:

“6. Njësitë e vetëqeverisjes vendore marrin masa që, pas miratimit, lejet e zhvillimit të integrohen me planin e përgjithshëm vendor, duke ndjekur përcaktimet e vendimit nr. 686, datë 22.11.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit”, të ndryshuar.”.

2. Në kreun IV bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Pas shkronjës “d”, të pikës 1, shtohet shkronja “e”, me këtë përmbajtje:

“e) rezultojnë në ndërtimin e shtëpive individuale sipas projekteve model të ndërtimit, të miratuara nga EKB-ja, me zhvillues njësitë zbatuese.”.

b) Në fund të pikës 2 shtohet fjalia, me këtë përmbajtje:

“Përfshihen shkronjat “c”, “ç”, “d” dhe “e”, të pikës 1, të këtij kreu.”.

c) Shkronja “c”, e pikës 3, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“c) dokumente që vërtetojnë të drejtat pasurore të pronës/ave që merr/marrin pjesë në një zhvillim/shpronësim për kalimin e pronësisë në favor të njërive të vetëqeverisjes vendore”.

ç) Pas shkronjës “g”, të pikës 3, shtohen shkronjat “h”, “i”, “j” dhe “k”, me këtë përmbajtje:

“h) Licencat në projektim të shoqërive projektuese/individëve projektues;

i) Leja e zhvillimit, për rastet sipas shkronjave “a” dhe “b”, të pikës 1, të këtij kreu;

j) Oponenca teknike për projektet e ndërtimit për të gjitha llojet e punimeve, me vlerë të preventivuar së paku 100 000 000 (njëqind milionë) lekë. Oponenca teknike për projektet e veprave të ndërtimit për të gjitha objektet publike që pajisen me leje ndërtimi kryhet nga Instituti i Ndërtimit. Përfshihet shkronja “e”, e pikës 1, të këtij kreu;

k) Rilevimi topografik i gjendjes faktike që zhvillohet, shk 1:500, hartuar nga topograf i licencuar.”.

d) Pas pikës 4 shtohet pika 4.1, me këtë përmbajtje:

“4.1. Dokumentet që duhet të dorëzojë aplikuesi për t’u pajisur me leje ndërtimi, për kategoritë e lejeve të ndërtimit të përcaktuara në shkronjën “e”, të pikës 1, të këtij kreu, janë:

a) akti i konstatimit për ndërtesën e dëmtuar, i hartuar nga strukturat përkatëse, të ngarkuara sipas legjislacionit në fuqi;

b) projekti i zbatimit, sipas objekteve tip, miratuar nga Enti Kombëtar i Banesave;

c) vendimi i këshillit bashkiak për miratimin e listës së përfituesve nga programi i rindërtimit;

ç) plani i rilevimit të truallit që do të zhvillohet, hartuar nga inxhinierë gjeodetë të licencuar;

d) plani i vendosjes së strukturës që do të zhvillohet.”.

dh) Shkronja “b”, e pikës 6, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“b) brenda 5 (pesë) ditëve pune, nga data e paraqitjes së aplikimit në sistemin *e-leje*, për lejet e përcaktuara në shkronjat “c”, “d”, dhe “e”, të pikës 1, të këtij kreu.”.

e) Pas paragrafit të parë, të pikës 7, shtohet paragrafi, me këtë përmbajtje:

“Pas përfundimit të objekteve sipas lejeve të ndërtimit të miratuara në rastet e fatkeqësive natyrore, organet e vetëqeverisjes vendore ushtrojnë kontroll mbi zbatimin e objektit, sipas kushteve të lejes së miratuar dhe pajisin objektet me certifikatë përdorimi.

Autoritetet vendore nxjerrin rregullore të brendshme të përcaktimit të procedurave dhe të dokumentacionit për kontrollin dhe certifikimin e objekteve.”.

II. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, njësitë e vetëqeverisjes vendore, sekretariati teknik i Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama



VENDIM
Nr. 737, datë 17.9.2020

**PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE
PËR ADMINISTRIMIN E FONDIT
KOMBËTAR TË KUJDESIT TË
TRASHËGIMISË KULTURORE
MATERIALE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 19, të ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, me propozimin e ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përcaktimin e rregullave për administrimin e Fondit Kombëtar të Kujdesit të Trashëgimisë Kulturore Materiale (në vijim Fondi).

2. Burimet e financimit të Fondit janë:

a) të ardhurat e krijuara nga vendet e artit e të kulturës, në kuptim të ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, si dhe muzetë;

b) të ardhurat dytësore të krijuara nga ofrimi i shërbimeve dhe përdorimi i pasurive kulturore në administrim të ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore ose institucioneve të specializuara në varësi të saj dhe në administrim të institucioneve në varësi të ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore dhe të muzeve publike;

c) financime vendase apo të huaja për këtë qëllim, të cilat burojnë në mënyrë të ligjshme nga organizata publike, private ose persona fizikë, të përfituara në formën e donacioneve ose të sponsorizimeve;

ç) buxheti i shtetit;

d) të ardhurat e gjeneruara nga kundërvajtjet administrative në masën 90%.

3. Të ardhurat e Fondit përdoren për mbështetjen e politikës kombëtare për ruajtjen, mbrojtjen dhe zhvillimin e vlerave të trashëgimisë kulturore materiale, në drejtimet kryesore, si më poshtë vijon:

a) kryerjen e ndërhyrjeve emergjente për konsolidimin, konservimin dhe restaurimin e pasurive kulturore;

b) realizimin e projekteve për zhvillimin, mbrojtjen, konservimin, restaurimin, rrijetëzimin e

pasurive kulturore dhe/ose përmes granteve apo instrumenteve të tjera të financimit;

c) realizimin e studimeve, dokumentimin në kuadër të mbrojtjes, të ruajtjes dhe të rehabilitimit të trashëgimisë kulturore materiale, siç përcaktohet në ligjin nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, si dhe hartimin e projekteve për mbrojtjen, konservimin, restaurimin e pasurive kulturore;

ç) zhvillimin e projekteve kulturore, me qëllim promovimin e trashëgimisë kulturore materiale;

d) trajnimin e stafit dhe të specialistëve, në të gjitha nivelet, në fushën e identifikimit, të mbrojtjes, të ruajtjes dhe të rehabilitimit të trashëgimisë kulturore materiale;

dh) zhvillimin e aktiviteteve të tjera të trashëgimisë kulturore, me miratimin e ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore.

4. Mënyra e përdorimit të të ardhurave, sipas burimit të krijimit të tyre, realizohet, si më poshtë vijon:

a) të ardhurat e krijuara sipas shkronjave “a” dhe “b”, të pikës 2, të këtij vendimi, përdoren në përputhje me ligjin nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”;

b) të ardhurat e krijuara sipas shkronjës “c”, të pikës 2, të këtij vendimi, përdoren në përputhje me marrëveshjet përkatëse, ndërmjet institucionit dhe subjektit, personit juridik, publik ose privat, vendas apo të huaj.

c) të ardhurat e krijuara sipas shkronjave “ç” dhe “d”, të pikës 2, të këtij vendimi, përdoren në përputhje me legjislacionin në fuqi për menaxhimin buxhetor e financiar.

5. Administrimi i të ardhurave të Fondit menaxhohet nga struktura kompetente pranë ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore (në vijim struktura).

6. Administrimi i llogarive të Fondit bëhet në përputhje me legjislacionin financiar të kontabilitetit dhe të raportimit financiar të parashikuar për institucionet publike.

7. Struktura kryen këto funksione:

a) përgatit dhe harton planifikimin strategjik dhe orientimet vjetore të përdorimit të Fondit, për qëllimet e përcaktuara nga ligji;

b) monitoron zbatimin e projekteve të financuara nga Fondi;



c) harton raportet financiare dhe administron programin financiar të Fondit, në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm;

ç) mbledh të dhëna, harton statistika dhe informacione të lidhura me përdorimin e Fondit;

d) harton raportin vjetor për përdorimin e Fondit, në bashkëpunim me drejtorinë përgjegjëse për buxhetin, pranë ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore;

dh) harton procedurat e aplikimit dhe kriteret e vlerësimit për administrimin e Fondit, mbi bazën e programit dhe të llojit të financimit;

e) harton dokumentacionin e nevojshëm, kontratën e lidhur me përfituesin e projektit.

8. Të ardhurat e përcaktuara në shkronjën “b”, të pikës 2, të këtij vendimi, përfshihen në të ardhura jashtë limitit, që mbarten në vitin buxhetor pasardhës. Këto të ardhura mbulojnë nevojat dhe aktivitetet e institucioneve sipas ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”.

9. Ngarkohen ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore dhe ministria përgjegjëse për financat për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 747, datë 23.9.2020

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA
NË VENDIMIN NR. 595, DATË 31.8.2016,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
SHPRONËSIMIN PËR INTERES
PUBLIK TË PRONARËVE TË PASURIVE
TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE,
QË PREKEN NGA REALIZIMI I
PROJEKTIT ‘NDËRTIMI DHE
SISTEMIMI I RRUGËS ‘GJYKATA –
AKADEMIA E MARINËS’ + RRUGA
‘DURO SHASKA’ DERI TEK 7
PALLATET, VLORË, FAZA I”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, të ligjit nr. 9936, datë

26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 595, datë 31.8.2016, të Këshillit të Ministrave, bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

1. Në pikat 3 dhe 4, vlera e përgjithshme e shpronësimit, për pasuritë e llojit “tokë truall” dhe “ndërtesë” nga 131 087 366 (njëqind e tridhjetë e një milionë e tetëdhjetë e shtatë mijë e treqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) lekë, ndryshon dhe bëhet 134 790 025 (njëqind e tridhjetë e katër milionë e shtatëqind e nëntëdhjetë mijë e njëzet e pesë) lekë.

2. Tabelës bashkëlidhur vendimit i shtohet tabela që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Shpenzimet procedurale në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë të përballohen nga buxheti i miratuar për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.

II. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Bashkia Vlorë dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Vlorë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe



Lista e pronave shtesë që shpronësohen nga realizimi i projektit: “Ndërtimi dhe sistemimi i Rugës ‘Gjykata – Akademia e Marinës’ + Rruga ‘Duro Shaska’ deri tek 7 Pallatet, Vlorë, Faza I”									
Nr.	ZK	Nr. i pasurisë	Adresa	Emri i pronarit	Lloji i pasurisë	Sip. që shpronësohet m ²	Çmimi i truallit lekë/m ²	Vlera e truallit lekë	Shënime
1	8602	36/175	Vlorë	Razie Shehu	Truall	239.6	10,903.00	2,612,358.80	Konfirmuar nga ASHK Vlorë
2	8602	36/117/6	Vlorë	Valentina Luari	Truall	100	10,903.00	1,090,300.00	Konfirmuar nga ASHK Vlorë
Shuma lekë								3,702,658.80	
Shënime: Për vlerësimin e pasurisë së llojit “tokë truall”, çmimi i llogaritur është marrë nga VKM-ja nr. 89, datë 3.2.2016, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”.									

VENDIM
Nr. 748, datë 23.9.2020

**PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES
PUBLIK TË PRONARËVE TË PASURIVE
TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE,
QË PREKEN NGA REALIZIMI I
PROJEKTIT “NDËRTIMI I SEGMENTIT
RRUGOR ‘ELBASAN–BANJË, LOTI II’,
ELBASAN”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Ndërtimi i segmentit rrugor ‘Elbasan–Banjë, loti II’, Elbasan”.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Autoritetit Rrugor Shqiptar (ARRSH).

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, të kompensohen në vlerë të plotë sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë e llojit “truall”, “arë” dhe “pemëtore”, me një vlerë të përgjithshme prej 9 201 065 (nëntë milionë e dyqind e një mijë e gjashtëdhjetë e pesë) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, për pasuritë e llojit “truall”, “arë” dhe “pemëtore”, me vlerë 9 201 065 (nëntë milionë e dyqind e një mijë e gjashtëdhjetë e pesë) lekë, do të përballohet nga

fondet e miratuara për Autoritetin Rrugor Shqiptar, për vitin 2020.

5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga fondet e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.

6. Shpronësimi të fillojë menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit të jetë 3 (tre) muaj pas datës së hyrjes në fuqi të tij.

7. Pronarët e pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, do të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar.

8. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Autoritetin Rrugor Shqiptar, të fillojë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale të regjistrimit, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar dhe të bëjë kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të shtetit, Autoritetit Rrugor Shqiptar.

9. Agjencia Shtetërore e Kadastrës të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin kur do të realizohet procesi i hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale të regjistrimit dhe kalimi i pronësisë në favor të shtetit, Autoritetit Rrugor Shqiptar, për pasuritë e shpronësuara.

10. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencia Shtetërore e Kadastrës dhe Autoriteti Rrugor Shqiptar për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDESKRYEMINISTËR
Erion Braçe



LISTA EMËRORE E PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE,
QË SHPRONËSOHEN SI REZULTAT I NDËRTIMIT TË SEGMENTIT RRUGOR “ELBASAN-BANJË, LOTI 2”

Nr.	PRONARI			Z. kadastrale	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja totale (m ²)	Sipërfaqe	Çmimi	Vlera	Vlera	Vlera	Adresa	Shënime
	Emri	Atësia	Mbiemri					shpronësimi (m ²)	lekë/m ²	në lekë	kult./drufrutorë	totale në lekë		
1	SHYQYRI	SHERIF	ROCI	2703	5/11	Arë	2125	1212	222	269,064	18,000	287,064	Njësia Administrative Mjekës	KONFIRMUAR
2	BP BOÇI			2703	5/3	Arë	1920	237.5	222	52,725	44,500	97,225	Njësia Administrative Mjekës	KONFIRMUAR
3	AQIF	SHERIF	ROCI	2703	5/7	Arë	3125	2524	222	560,328	96,000	656,328	Njësia Administrative Mjekës	KONFIRMUAR
4	RAMIZ	VESEL	ROCI	2703	5/8/1	Arë	1815	1486	222	329,892	69,800	399,692	Njësia Administrative Mjekës	KONFIRMUAR
5	SHKELQIM	QANI	ROCI	2703	5/9	Arë	1000	417	222	92,574	75,800	168,374	Njësia Administrative Mjekës	KONFIRMUAR
6	RAMADAN		ROCI	2703	5/10	Arë	800	302	222	67,044	13,000	80,044	Njësia Administrative Mjekës	KONFIRMUAR
7	TASI	VASIL	ROCI	2703	5/6	Arë	812	383	222	85,026	10,000	95,026	Njësia Administrative Mjekës	KONFIRMUAR
8	PULJE, ANASTAS, BUKURI	RISTO, JORGJI, APOSTOL	DOKA	2703	5/4/1	Arë	3835	1215	222	269,730	100,800	370,530	Njësia Administrative Mjekës	KONFIRMUAR
9		SHTET		2703	5/14	Arë	750	156	0	0		0	Njësia Administrative Mjekës	KONFIRMUAR
9	BASHKIM	FEIM	ROCI	2703	16/1	Pemëtores	1125	267	222	59,274		59,274	Njësia Administrative Mjekës	KONFIRMUAR
10	BESIM	MAHMUT	ROCI	2703	16/4	Truall	250	39	264	10,296		10,296	Njësia Administrative Mjekës	KONFIRMUAR
11	IDRIZ	XHEMAL	KYCYKU	2703	16/6	Truall	250	195	264	51,480		51,480	Njësia Administrative Mjekës	KONFIRMUAR
12		BP Bajrami, Murrati, Xibraku, Sina, Muca		2703	93/1	Arë	1500	201	222	44,622		44,622	Njësia Administrative Mjekës	KONFIRMUAR
13	NDRICIM	FAIK	BAJRAMI	2703	93/2	Arë	1000	46	222	10,212		10,212	Njësia Administrative Mjekës	KONFIRMUAR
14	DEMIR	RESHIT	BAJRAMI	2703	93/3	Arë	1595	272	222	60,384		60,384	Njësia Administrative Mjekës	KONFIRMUAR
15	AGRON	DEMIR	BAJRAMI	2703	93/4	Truall	250	97	264	25,608		25,608	Njësia Administrative Mjekës	KONFIRMUAR
16	SHYQYRI, NADIRE	FETAH, NAZMI	ÇEKREZI	2703	42/33	Arë	3500	20	222	4,440		4,440	Njësia Administrative Mjekës	KONFIRMUAR



17	JASHAR	RIZA	KULLOLLI	2703	124/19	Arë	527	310	222	68,820		68,820	Njësia Administrative Mjekës	KONFIRMUAR
18	ARDJAN	SULEJMAN	PREÇI	2703	124/31	Arë	940	18	222	3,996		3,996	Njësia Administrative Mjekës	KONFIRMUAR
19	ARDJAN	HYSNI	RUÇI	2703	124/32	Arë	839	68	222	15,096		15,096	Njësia Administrative Mjekës	KONFIRMUAR
20	FLUTUR AIDA FESTIM ANDI	QEMAL IBRAHIM IBRAHIM	ÇEKREZI	2703	124/33	Arë	1320	329	222	73,038		73,038	Njësia Administrative Mjekës	KONFIRMUAR
21	FLUTUR AIDA FESTIM ANDI	QEMAL IBRAHIM IBRAHIM	ÇEKREZI	2703	126/10	Arë	2365	76	222	16,872		16,872	Njësia Administrative Mjekës	KONFIRMUAR
22	SHYQYRI NADIRE	FETAH, NAZMI	ÇEKREZI	2703	126/9	Arë	1974	50	222	11,100		11,100	Njësia Administrative Mjekës	KONFIRMUAR
23	QEMAL	FEHTA	CEKREZI	2703	126/8	Arë	2024	31	222	6,882		6,882	Njësia Administrative Mjekës	KONFIRMUAR
24	NURI	EMIN	CEKREZI	2703	126/7	Arë	2177	26	222	5,772		5,772	Njësia Administrative Mjekës	KONFIRMUAR
25	AVNI	EMIN	CEKREZI	2703	126/6	Arë	1982	30	222	6,660		6,660	Njësia Administrative Mjekës	KONFIRMUAR
26	BEDRI	EMIN	CEKREZI	2703	126/5	Arë	2242	35	222	7,770		7,770	Njësia Administrative Mjekës	KONFIRMUAR
27	SELMAN	EMIN	CEKREZI	2703	126/4	Arë	2088	35	222	7,770		7,770	Njësia Administrative Mjekës	KONFIRMUAR
28	HAXHI	SHERIF	CEKREZI	2703	126/3	Arë	2103	31	222	6,882		6,882	Njësia Administrative Mjekës	KONFIRMUAR
29	MEREME SAIMIR MARJETA ZYBEJTE	DALIP ILIR RYZHDI	ÇEKREZI	2703	126/2	Arë	2182	33	222	7,326		7,326	Njësia Administrative Mjekës	KONFIRMUAR
30	HALIM	BEQIR	CEKREZI	2703	126/1	Arë	2361	27	222	5,994		5,994	Njësia Administrative Mjekës	KONFIRMUAR
31	MURAT	FEZULLA	CEKREZI	2703	127/6	Arë	5345	430	222	95,460		95,460	Njësia Administrative Mjekës	KONFIRMUAR
32	RAJMONDA	KOSTANDIN	GANCI	2703	131/4	Truall	250	60	264	15,840		15,840	Njësia Administrative Mjekës	KONFIRMUAR
33	YLLI	PASHO	KULLOLLI	2703	83/6	Arë	2625	16	222	3,552		3,552	Njësia Administrative Mjekës	KONFIRMUAR
34	I PAIDENTIFIKUAR			2703	16/5	Pemëtores	2185	696	222	154,512		154,512	Njësia Administrative Mjekës	
35	BP PALLOSHI, LABINOTI DHE FURXHI			8526	605	Truall	7290	491	12,764	6,267,124		6,267,124	Bashkia Elbasan	KONFIRMUAR
Vlera totale e shpronësimit								11861.5		8,773,165	427,900	9,201,065		



VENDIM

Nr. 749, datë 23.9.2020

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN
NR. 695, DATË 31.7.2013, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR
SHPRONËSIMIN PËR INTERES
PUBLIK TË PRONARËVE TË PASURIVE
TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE,
QË PREKEN NGA NDËRTIMI I
SEGMENTIT RRUGOR ‘ZGJERIMI I
RRUGËS SË ELBASANIT (FAKULTETI I
HISTORISË DHE I FILOLOGJISË–
UNAZA E MADHE E TIRANËS)’”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në pikën 4, të vendimit nr. 695, datë 31.7.2013, të Këshillit të Ministrave, fjalët “... ndërsa pjesa e mbetur, në masën 83 911 577 (tetëdhjetë e tre milionë e nëntëqind e njëmbëdhjetë mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e shtatë) lekë, do të përballohet sipas mënyrës që do të përcaktohet me vendim të veçantë të Këshillit të Ministrave.” zëvendësohen me “... pjesa e mbetur, në masën 83 911 577 (tetëdhjetë e tre milionë e nëntëqind e njëmbëdhjetë mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e shtatë) lekë, do të përballohet nga fondet e Autoritetit Rrugor Shqiptar, sipas tabelës bashkëlidhur vendimit.”.

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Autoriteti Rrugor Shqiptar për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe**

VENDIM

Nr. 750, datë 23.9.2020

**PËR MBYLLJEN E VEPRIMTARISË SË
INSTITUCIONIT ARSIMOR
PARAUNIVERSITAR PRIVAT,
MEDRESEJA “ALI KORÇA”, KAVAJË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 42, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Mbylljen e veprimtarisë së institucionit arsimor parauniversitar privat, medreseja “Ali Korça”, Kavajë, hapur me vendimin nr. 560, datë 26.8.1996, të Këshillit të Ministrave, “Për dhënie leje për funksionimin e institucioneve arsimore private”.

2. Institucioni arsimor privat fetar, i nivelit të arsimit të mesëm të lartë, medreseja “Ali Korça”, Kavajë, ka këto detyrime:

a) të pajisë çdo nxënës me dokumentacionin e nevojshëm shkollor, që do të shërbejë për transferimin e tij në një institucion tjetër të arsimit parauniversitar;

b) të vërë në dispozicion të institucionit arsimor vendor përgjegjës për arsimin parauniversitar çdo informacion të kërkuar deri në plotësimin dhe mbylljen e të gjitha kërkesave të parashikuara në këtë vendim;

c) të kthejë pagesat e kryera (nëse ka) nga prindi/përfaqësuesi ligjor i nxënësit për pjesën e papërfunduar të shkollimit, si dhe çdo detyrim tjetër të papërmbytur që mund të ketë ndaj nxënësit;

ç) të dorëzojë në Arkivin Shtetëror Vendor dokumentacionin dhe të paraqesë në institucionin arsimor vendor përgjegjës për arsimin parauniversitar një kopje të procesverbalit të dorëzimit dhe të dokumentacionit, sipas afateve të parashikuara në legjislacionin në fuqi;

d) të gjitha shpenzimet për kryerjen e procedurave për transferimin e nxënësve, në zbatim të këtij vendimi, të mbulohen nga institucioni përkatës i arsimit privat.



3. Institucioni arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar, nën juridiksionin e të cilit ndodhet shkolla, ka për detyrë:

a) të ngrejë grup pune brenda 3 (tri) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi dhe të marrë masat për mbylljen e veprimtarisë së institucionit arsimor privat, Medreseja “Ali Korça”, Kavajë;

b) të marrë masat për transferimin e nxënësve në institucione të tjera të arsimit parauniversitar për të gjithë nxënësit e regjistruar në këtë institucion arsimor;

c) të administrojë dokumentacionin lidhur me veprimtarinë mësimore të kryer nga institucioni arsimor privat.

4. Institucioni arsimor vendor përgjegjës për arsimin parauniversitar të marrë të gjitha masat sipas parashikimeve të Kodit Civil, të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar, si dhe akteve ligjore e nënligjore në fuqi për personin juridik që përfaqëson institucionin e përcaktuar në pikën 1, i cili nuk zbaton këtë vendim.

5. Nënndarja 2, e shkronjës “d”, të pikës 1, të vendimit nr. 560, datë 26.8.1996, të Këshillit të Ministrave, “Për dhënie leje për funksionimin e institucioneve arsimore private”, shfuqizohet.

6. Ngarkohen Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, institucioni arsimor vendor përgjegjës për arsimin parauniversitar, institucioni arsimor privat, medreseja “Ali Korça”, Kavajë dhe Komuniteti Mysliman i Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

VENDIM
Nr. 751, datë 23.9.2020

**PËR MBYLLJEN E VEPRIMTARISË SË
INSTITUCIONIT ARSIMOR
PARAUNIVERSITAR PRIVAT, “KRYQI I
NDERUAR”, SUKTH, DURRËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 42, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e

ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Mbylljen e veprimtarisë së institucionit arsimor parauniversitar privat, të arsimit të mesëm të lartë, “Kryqi i nderuar”, Sukth, Durrës.

2. Institucioni arsimor parauniversitar privat, “Kryqi i nderuar”, ka këto detyrime:

a) të pajisë çdo nxënës me dokumentacionin e nevojshëm shkollor, që do të shërbejë për transferimin e tij në një institucion tjetër të arsimit parauniversitar;

b) të mbulojë të gjitha shpenzimet për kryerjen e procedurave për transferimin e nxënësve, në zbatim të këtij vendimi;

c) të kthejë pagesat e kryera (nëse ka) nga prindi/përfaqësuesi ligjor i nxënësit për pjesën e papërfunduar të shkollimit, si dhe çdo detyrim tjetër të papërmbytur që mund të ketë ndaj nxënësit;

ç) të vërë në dispozicion të institucionit arsimor vendor përgjegjës për arsimin parauniversitar çdo informacion të kërkuar deri në plotësimin e të gjitha kërkesave të parashikuara në këtë vendim;

d) të dorëzojë në institucionin arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar, dokumentacionin shkollor dhe procesverbalin e dorëzimit të tij, sipas afateve të parashikuara në legjislacionin në fuqi.

3. Institucioni arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar, nën juridiksionin e të cilit ndodhet shkolla, ka për detyrë:

a) të ngrejë grup pune brenda 3 (tri) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi dhe të marrë masat për mbylljen e veprimtarisë së institucionit arsimor parauniversitar privat, “Kryqi i nderuar”.

b) Të marrë masat për transferimin e nxënësve në institucione të tjera të arsimit parauniversitar për të gjithë nxënësit e regjistruar në këtë institucion arsimor;

c) Të administrojë të gjithë dokumentacionin lidhur me veprimtarinë mësimore të kryer nga institucioni arsimor parauniversitar privat.

4. Institucioni arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar, të marrë të gjitha masat sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

5. Vendimi nr. 743, datë 1.7.2009, i Këshillit të Ministrave, “Për dhënien e licencës për hapjen e



institucionit arsimor privat parauniversitar, shkollë e mesme, ‘Kryqi i nderuar’”, shfuqizohet.

6. Ngarkohen Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar (DPAP), institucioni arsimor vendor përgjegjës për arsimin parauniversitar, institucioni arsimor parauniversitar privat, “Kryqi i nderuar”, Sukth, Durrës dhe Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

VENDIM
Nr. 752, datë 23.9.2020

PËR MBYLLJEN E VEPRIMTARISË SË
INSTITUCIONIT ARSIMOR
PARAUNIVERSITAR PRIVAT,
MEDRESEJA “HAFIZ ABDULLAH
ZËMBLAKU”, KORÇË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 42, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Mbylljen e veprimtarisë së institucionit arsimor parauniversitar privat, fetar, të nivelit të arsimit të mesëm të lartë, medreseja “Hafiz Abdullah Zëmbaku”, Korçë, hapur me vendimin nr. 602, datë 4.12.2002, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e lejes së funksionimit të institucionit arsimor privat, medreseja ‘Hafiz Abdullah Zëmbaku’”.

2. Institucioni arsimor parauniversitar privat, medreseja “Hafiz Abdullah Zëmbaku”, Korçë, ka këto detyrime:

a) të pajisë çdo nxënës me dokumentacionin e nevojshëm shkollor, që do të shërbejë për transferimin e tij në një institucion tjetër të arsimit parauniversitar;

b) të vërë në dispozicion të institucionit arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar, çdo

informacion të kërkuar deri në plotësimin dhe mbylljen e të gjitha kërkesave të parashikuara në këtë vendim;

c) të kthejë pagesat e kryera nga nxënësit për pjesën e papërfunduar të shkollimit, si dhe çdo detyrim tjetër të papërmbyshur që mund të ketë ndaj nxënësit;

ç) të dorëzojë në Arkivin Shtetëror Vendor dokumentacionin dhe të paraqesë në institucionin arsimor vendor përgjegjës për arsimin parauniversitar një kopje të procesverbalit të dorëzimit dhe të dokumentacionit, sipas afateve të parashikuara në legjislacionin në fuqi;

d) të gjitha shpenzimet për kryerjen e procedurave për transferimin e nxënësve, në zbatim të këtij vendimi të mbulohen nga institucioni përkatës i arsimit privat.

3. Institucioni arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar, nën juridiksionin e të cilit ndodhet shkolla, ka për detyrë:

a) të ngrejë grup pune brenda 3 (tri) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi dhe të marrë masat për mbylljen e veprimtarisë së institucionit arsimor privat, medreseja “Hafiz Abdullah Zëmbaku”, Korçë.

b) të marrë masat për transferimin e nxënësve në institucione të tjera të arsimit parauniversitar për të gjithë nxënësit e regjistruar në këtë institucion arsimor;

c) të administrojë dokumentacionin lidhur me veprimtarinë mësimore të kryer nga institucioni arsimor privat.

4. Institucioni arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar, të marrë të gjitha masat sipas parashikimeve të Kodit Civil, të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar, si dhe të akteve ligjore e nënligjore në fuqi për personin juridik që përfaqëson institucionin e përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, i cili nuk zbaton këtë vendim.

5. Vendimi nr. 602, datë 4.12.2002, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e lejes së funksionimit të institucionit arsimor privat, medreseja ‘Hafiz Abdullah Zëmbaku’”, shfuqizohet.

6. Ngarkohen Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, institucioni arsimor vendor përgjegjës për arsimin parauniversitar, institucioni arsimor privat medreseja “Hafiz



Abdullah Zëmbaku”, Korçë dhe Komuniteti Mysliman i Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

VENDIM
Nr. 753, datë 23.9.2020

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 682, DATË 29.7.2015, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRDORIMIN E FONDEVE PUBLIKE PËR TRANSPORTIMIN E PUNONJËSVE ARSIMORË QË PUNOJNË DHE TË NXËNËSVE QË MËSOJNË JASHTË VENDBANIMIT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të neneve 5, 6, 19 e 28, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; të ligjit nr. 8308, datë 18.3.1998, “Për transportet rrugore”, të ndryshuar; të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas shkronjës “ç”, të pikës 1, të vendimit nr. 682, datë 29.7.2015, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohet shkronja “d”, me këtë përmbajtje:

“d) nxënësve që ndjekin procesin mësimor në institucionet arsimore publike, të arsimit të mesëm të lartë dhe të arsimit profesional, godinat e të cilave kanë dalë jashtë funksionit apo janë në rikonstruksion/rindërtim, vërtetuar me aktet përkatëse, sipas legjislacionit në fuqi dhe që udhëtojnë mbi 5 km për të ndjekur procesin mësimor, larg vendbanimit të përhershëm.”.

2. Ngarkohen Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe institucionet arsimore vendore, përgjegjëse

për arsimin parauniversitar, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

VENDIM
Nr. 754, datë 23.9.2020

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 371, DATË 6.5.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR DHËNIE SHPËRBLIMI PËR PERSONELIN QË SHËRBEN NË INSTITUCIONET E PËRKUJDESJES SHOQËRORE REZIDENCIALE PUBLIKE, QË JANË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË SHËRBIMIT SOCIAL SHTETËROR DHE TË BASHKIVË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Pika 1, e vendimit nr. 371, datë 6.5.2020, të Këshillit të Ministrave, ndryshohet si më poshtë vijon:

“1. Dhënien e një shpërblimi në masën 55 000 (pesëdhjetë e pesë mijë) lekë, për personelin që shërben në institucionet e përkujdesjes shoqërore rezidenciale publike, që janë në përgjegjësi administrimi të Shërbimit Social Shtetëror dhe të bashkive, të angazhuar në shërbimin ndaj përfituesve të sistemuar në këto institucione deri më 31 gusht 2020.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

**VENDIM****Nr. 755, datë 23.9.2020**

**PËR RISHPËRNDARJE FONDESH
BUXHETORE, NDËRMJET
PROGRAMEVE TË MIRATUARA NË
BUXHETIN E VITIT 2020,
PËR MINISTRINË E SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 44, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 5, të ligjit nr. 88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në buxhetin e vitit 2020, të miratuar për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, bëhet rishpërndarja e fondeve, si më poshtë vijon:

a) Në programin buxhetor 07220, “Shërbimet e kujdesit parësor”, në artikullin 604, “Të tjera transferime korrente të brendshme”, të shtohet fondi prej 406 000 000 (katërqind e gjashtë milionë) lekësh.

b) Në programin buxhetor 07330, “Shërbimet e kujdesit dytësor”, në artikullin 604, “Të tjera transferime korrente të brendshme”, të pakësohet fondi prej 406 000 000 (katërqind e gjashtë milionë) lekësh.

2. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe**

VENDIM**Nr. 756, datë 23.9.2020**

**PËR FUNKSIONIMIN E KOMISIONIT
TË PËRBASHKËT TË SHQIPËRISË
DHE KOSOVËS PËR MIRATIMIN E
TEKSTEVE TË PËRBASHKËTA
PËR DIASPORËN**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5, të ligjit nr. 16/2018, “Për diasporën”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Diasporën, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Komisioni i Përbashkët i Shqipërisë dhe Kosovës për miratimin e teksteve mësimore të përbashkëta për diasporën, në zbatim të marrëveshjes së bashkëpunimit, ndërmjet Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë të Republikës së Shqipërisë, Ministrisë së Diasporës së Republikës së Kosovës dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së Republikës së Kosovës, për organizimin e përbashkët të mësimin të gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në diasporë dhe mërgatë, datë 23.3.2015, përbëhet nga përfaqësuesit e institucioneve, si më poshtë vijon:

a) 5 (pesë) përfaqësues nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës së Republikës së Kosovës dhe Ministria për Punët e Jashtme dhe Diasporën së Republikës së Kosovës;

b) 5 (pesë) përfaqësues nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë së Republikës së Shqipërisë dhe ministri i Shtetit për Diasporën.

2. Komisioni i Përbashkët i Shqipërisë dhe Kosovës për miratimin e teksteve mësimore të përbashkëta për diasporën ka për detyrë:

a) hartimin e standardeve të teksteve mësimore të përbashkëta për diasporën;

b) hartimin e paketës së dokumenteve për procedurat e konkurrimit për tekstet mësimore të përbashkëta për diasporën;

c) përcaktimin e kriterëve të recensuesve të teksteve mësimore të përbashkëta për diasporën;

ç) miratimin e teksteve mësimore të përbashkëta fituese për diasporën.

3. Qendra e Botimeve për Diasporën kryen funksionet e sekretariatit teknik të Komisionit të Përbashkët të Shqipërisë dhe Kosovës për



miratimin e teksteve mësimore të përbashkëta për diasporën.

4. Shpenzimet për mbarëvajtjen e punës së Komisionit, përfshirë udhëtimin, akomodimin dhe dietat, për realizimin e mbledhjeve zyrtare të anëtarëve të Komisionit të Përbashkët të Shqipërisë dhe Kosovës, për pagesën e recensuesve të teksteve dhe proceseve të tjera në shërbim të procesit, mbulohen nga buxheti i miratuar i Qendrës së Botimeve për Diasporën të Republikës së Shqipërisë, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

5. Pagesat e pikës 4 të këtij vendimi, propozohen rast pas rasti nga drejtori i Qendrës së Botimeve për Diasporën dhe miratohen nga Këshilli Koordinues i Botimeve për Diasporën.

6. Ngarkohen Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe ministri i Shtetit për Diasporën për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

VENDIM
Nr. 758, datë 23.9.2020

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 587, DATË 22.7.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT, PËR FINANCIMIN E RINDËRTIMIT TË NJËSIVE TË BANIMIT NË NDËRTESA (PALLAT), TË DËMTUARA, NË ZONAT E SHPALLURA PËR ZHVILLIM TË DETYRUAR”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja “b”, nënndarja “i”, 16, pika 3, dhe 36, pika 1, shkronja “a”, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, “Për përbashkimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në pikat 2 dhe 3, të vendimit nr. 587, datë 22.7.2020, të Këshillit të Ministrave, shifra “... 3 239 666 018 (tre miliardë e dyqind e tridhjetë e nëntë milionë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e tetëmbëdhjetë) ...” zëvendësohet me “... 2 239 666 018 (dy miliardë e dyqind e tridhjetë e nëntë milionë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e tetëmbëdhjetë) ...”.

2. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Fondi Shqiptar i Zhvillimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

VENDIM
Nr. 759, datë 23.9.2020

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 202, DATË 5.3.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT, MIRATUAR NË BUXHETIN E VITIT 2020, PËR FINANCIMIN E RINDËRTIMIT TË BANESAVE INDIVIDUALE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja “b”, nënndarja “i”, 16, pika 3, dhe 36, pika 1, shkronja “a”, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, “Për përbashkimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në pikën 2.1, të vendimit nr. 202, datë 5.3.2020, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhet ndryshimi si më poshtë vijon:



“2.1 Fondi që do të përdoret, i miratuar në buxhetin e vitit 2020, do të jetë 4 633 532 035 (katër miliardë e gjashtëqind e tridhjetë e tre milionë e pesëqind e tridhjetë e dy mijë e tridhjetë e pesë) lekë pa TVSH, nga i cili:

a) Fondit Shqiptar të Zhvillimit, në buxhetin e miratuar për vitin 2020, në zërin “Shpenzime kapitale me financim të brendshëm”, të programit 06210 “Programe zhvillimi”, i shtohet fondi prej 2 733 483 882 (dy miliardë e shtatëqind e tridhjetë e tre milionë e katërqind e tetëdhjetë e tre mijë e tetëqind e tetëdhjetë e dy) lekësh pa TVSH, për financimin e rindërtimit të banesave individuale, brenda dhe jashtë zonave të reja për zhvillim, ndërtimin dhe rikonstruksionin e infrastrukturës publike, si dhe çdo ndërhyrje tjetër, në funksion të rindërtimit të banesave individuale, jashtë zonave të reja për zhvillim.”.

2. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Fondi Shqiptar i Zhvillimit dhe Bashkia Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

VENDIM
Nr. 761, datë 23.9.2020

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 307, DATË 16.4.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT, PËR FINANCIMIN E RIKONSTRUKSIONIT DHE NDËRTIMIT TË INFRASTRUKTURËS PUBLIKE, NË FUNKSION TË RINDËRTIMIT TË BANESAVE INDIVIDUALE DHE KAKTIMIT E FONDIT SHQIPTAR TË ZHVILLIMIT SI NJËSI ZBATUESE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja “b”, nënndarja “i”, 16 dhe 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për

menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pika 3, e vendimit nr. 307, datë 16.4.2020, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ndryshohet si më poshtë vijon:

“3. Përdorimi i fondit, i miratuar në buxhetin e vitit 2020, do të jetë në masën 2 477 077 257 (dy miliardë e katërqind e shtatëdhjetë e shtatë milionë e shtatëdhjetë e shtatë mijë e dyqind e pesëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH, nga të cilat:

a) Fondit Shqiptar të Zhvillimit, në buxhetin e miratuar për vitin 2020, në zërin “Shpenzime kapitale me financim të brendshëm”, të programit 06210 “Programe zhvillimi”, i shtohet fondi në masën 795 080 370 (shtatëqind e nëntëdhjetë e pesë milionë e tetëdhjetë mijë e treqind e shtatëdhjetë) lekë pa TVSH, për financimin e ndërtimit dhe të rikonstruksionit të infrastrukturës publike në zonat e reja të shpallura për zhvillim, në bashkitë Tiranë, Durrës, Kavajë, Krujë, Kurbin, Lezhë, Shijak e Vorë.

b) Bashkisë Tiranë i transferohet fondi në masën 1 681 996 887 (një miliard e gjashtëqind e tetëdhjetë e një milionë e nëntëqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e tetëqind e tetëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH, në formën e transfertës së pakushtëzuar, për financimin e ndërtimit dhe të rikonstruksionit të infrastrukturës publike në zonat e reja të shpallura për zhvillim, në Bashkinë Tiranë.”.

2. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Fondi Shqiptar i Zhvillimit dhe Bashkia Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

**UDHËZIM I PËRBASHKËT**

Nr. 3/3, datë 8.9.2020

**PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN
NR. 3, DATË 24.2.2020, “PËR KRITERET,
PROCEDURAT DHE MËNYRËN E
ADMINISTRIMIT TË FONDIT TË
PROGRAMIT PËR BUJQËSINË
DHE ZHVILLIMIN RURAL”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të nenit 6, pika 3, të ligjit nr. 9817, datë 22.10.2007, “Për bujqësinë dhe zhvillimin rural”, të ligjit nr. 88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020”, të pikës 4, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 100, datë 5.2.2020, “Për përcaktimin e kriterëve bazë, të sektorëve që do të mbështeten dhe të masës së përfitimit nga Fondi i Programit për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural për vitin 2020”,

UDHËZUJME:

Në udhëzimin nr. 3, datë 24.2.2020, “Për kriteret, procedurat dhe mënyrën e administrimit të Fondit për Programin e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural”, të ndryshuar, bëhet ndryshimi si më poshtë vijon:

Në kreun X, në pikën 1, togfjalëshi “jo më vonë se data 30.6.2020”, zëvendësohet me togfjalëshin “jo më vonë se data 31.10.2020”.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

**MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Bledar Çuçi**

**MINISTËR I FINANCAVE DHE
EKONOMISË
Anila Denaj**

VENDIM

Nr. 200, datë 23.9.2020

**PËR MIRATIMIN ERREGULLORES
“MBI KRITERET DHE PROCEDURAT E
NGRITJES NË DETYRË NË
POZICIONIN E DREJTUESIT NË
PROKURORITË E JURIDIKSIONIT TË
PËRGJITHSHËM”**

Bazuar në nenin 149/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenet 47, 52 dhe 174, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, nenet 184/ç dhe 189, të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar dhe të nenin 41, të ligjit nr. 97/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, Këshilli i Lartë i Prokurorisë

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullores “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë në pozicionin e drejtuesit në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e botimit në Fletoren Zyrtare dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

**KRYETAR
Gent Ibrahimi**

**RREGULLORE
MBI KRITERET DHE PROCEDURAT E
NGRITJES NË DETYRË NË POZICIONIN E
DREJTUESIT NË PROKURORITË E
JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM**

SEKSIONI I

**KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1
Qëllimi**

Qëllimi i kësaj Rregulloreje është përcaktimi i kriterëve dhe i procedurave për ngritjen në detyrë



të prokurorëve në pozicionin Drejtuesit të Prokurorisë të Juridiksionit të Përgjithshëm, bazuar në parimet e meritokracisë dhe të zhvillimit të karrierës.

Neni 2 Fusha e zbatimit

1. Dispozitat e kësaj Rregulloreje janë të zbatueshme për vlerësimin dhe për renditjen e prokurorëve që kandidojnë dhe që përmbushin kriteret ligjore për t'u ngritur në detyrë në pozicionet e mëposhtme:

a) Drejtues në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit të juridiksionit të përgjithshëm;

b) Drejtues në Prokurorinë pranë Gjykatës të Shkallës së Parë të juridiksionit të përgjithshëm.

2. Këto rregulla zbatohen për pozicionet e lira të përhershme, për pozicionet që priten të bëhen të lira brenda tre muajve, nga thirrja e Këshillit për këto pozicione, si dhe për pozicionet e lira të përkohshme, për aq sa është e mundur.

Neni 3 Subjektet

Subjektet e kësaj rregulloreje janë prokurorët, të cilët plotësojnë kushtet e parashikuara nga nenet 47 dhe 52, të ligjit nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, për ngritjen në detyrë në pozicionin e drejtuesit.

Neni 4 Përkufizime

Për qëllime të kësaj Rregulloreje, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) "**Këshilli**" është Këshilli i Lartë i Prokurorisë.

b) "**Kandidat**" është prokurori që është pranuar nga Këshilli në procedurën e mëtejshme të ngritjes në detyrë, pas verifikimit të përmbushjes së kushteve ligjore dhe pas kalimit me sukses të procedurës së verifikimit të pasurisë dhe të figurës.

c) "**Ligji për statusin**" është ligji nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

ç) "**Ngritje në detyrë**", për qëllim të kësaj rregulloreje, është kalimi nga një pozicion si prokuror, në pozicionin e drejtuesit të prokurorisë.

d) "**Riemërim**", për qëllim të kësaj rregulloreje, është kalimi nga një pozicion si drejtues në detyrë, nëpërmjet kandidimit për një mandat të dytë, në pozicionin e drejtuesit në po atë zyrë prokurorie.

dh) "**Nivel vlerësimi**" është rezultati i përgjithshëm i vlerësimit etik dhe profesional të prokurorit, sipas sistemit të vlerësimit të kohës. Në rastin e prokurorëve të komanduar, niveli i vlerësimit nga institucioni ku prokurori është komanduar njihet si nivel vlerësimi në kuptim të kësaj rregulloreje, në përputhje me nenin 53, pika 10, e ligjit për statusin.

e) "**Vlerësim i mëparshëm**" nënkupton çdo vlerësim etik dhe profesional ekzistues të veprimtarisë së prokurorit.

ë) "**Nivel i barabartë vlerësimi etik dhe profesional**" është kur dy ose më shumë kandidatë për të njëjtin pozicion të lirë kanë nivel të barabartë vlerësimi, nëse në dy vlerësimet e fundit etike dhe profesionale, niveli i vlerësimit të tyre është i njëjtë.

f) "**Vlerësim i posaçëm**" është vlerësimi që kryhet për nevoja të procedurës së ngritjes në detyrë, sipas kriterëve dhe skemës së pikëzimit të parashikuar në këtë rregullore.

g) "**Pozicion i lirë i përhershëm**" është pozicioni për të cilin nuk ka prokurorë me të drejtën për t'u kthyer në atë pozicion, siç përcakton pika 2, e nenit 42, të ligjit për statusin;

gj) "**Pozicion i lirë përkohësisht**" është pozicioni kur prokurori që ka atë pozicion në mënyrë të përhershme, për të paktën 3 muaj, është përkohësisht në pamundësi për të ushtruar funksionin në atë pozicion.

h) "**Pozicion që pritet të bëhet i lirë**" është pozicioni i drejtuesit në prokurori të juridiksionit të përgjithshëm, i cili pritet të bëhet i lirë brenda tre muajve nga momenti i shpalljes së procedurës së lëvizjes paralele.

i) "**Përvojë profesionale specifike**" nënkupton përvojën e veçantë të punës, të përshtatshme për pozicionin e lirë të shpallur.

j) "**Komisioni**" është Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

k) "**Vendim kualifikimi**" nënkupton vendimet e Këshillit, pas përfundimit të verifikimit të kushteve ligjore për kandidimin dhe procedurave të kryera për verifikimin e plotë të pasurisë dhe figurës, sipas vendimit nr. 171, datë 27.9.2019, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, "Rregullore për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve



ligjore për rekrutimin, emërimin si magistrat dhe caktimin në pozicion të kandidatëve për prokurorë, si dhe për zhvillimin e karrierës së prokurorëve”.

1) “**Vendim për renditjen e kandidatëve**” nënkupton vendimin e Këshillit të marrë në përfundim të një procedure përzgjedhjeje për ngritjen në detyrë, bazuar në kriteret e përcaktuara në nenin 52, pika 10, të ligjit për statusin.

2) “**Vendim për ngritjen në detyrë në pozicionin e drejtuesit**”, nënkupton vendimin e Këshillit për ngritjen në detyrë të kandidatit të renditur më lart në një procedurë përzgjedhjeje.

SEKSIONI II SHPALLJA, KANDIDIMI DHE KUALIFIKIMI

KREU I HAPJA E PROCEDURËS PËR NGRITJEN NË DETYRË NË POZICIONIN E DREJTUESIT

Neni 5

Shpallja e pozicionit të lirë dhe thirrja për paraqitjen e shprehjes së interesit

1. Jo më vonë se tre muaj para mbarimit të mandatit të kryetarit në detyrë, Këshilli, mbi propozimin e Komisionit, merr vendim për shpalljen e pozicionit të lirë të drejtuesit dhe bën thirrje për paraqitjen e shprehjes së interesit.

2. Thirrja përmban informacionin e nevojshëm, sipas parashikimeve të nenit 52, pika 8, të ligjit për statusin.

3. Thirrja shpallet në faqen zyrtare të Këshillit dhe qëndron e hapur për një periudhë prej 2 javësh nga e nesërmja e shpalljes dhe përfundon në orën 24:00 të ditës së fundit. Afati për paraqitjen e shprehjes së interesit mund të zgjatet, kur është e nevojshme, me vendim të arsyetuar të Këshillit.

4. Prokurorët e interesuar paraqesin një kërkesë me shkrim drejtuar Këshillit për të shprehur interesin dhe për të dëshmuar kualifikimet e tyre. Prokurori i interesuar mund të kandidojë për jo më shumë se tri pozicione të shpallura dhe nëse kandidon për më shumë se një pozicion, ai bën renditjen e tyre sipas preferencës. Pozicionet preferenciale do të vlerësohen sipas rendit të citimit në kërkesë.

KREU II KANDIDIMI

Neni 6 Shprehja e interesit

1. Prokurori i interesuar duhet të paraqesë një aplikim të plotë dhe vlerësimi i tij bëhet mbi bazën e dokumenteve të dorëzuara dhe të intervistës.

2. Kërkesa me shkrim shoqërohet nga dokumentet e mëposhtme:

a) kërkesa për shprehjen e interesit për të kandiduar për pozicionin e lirë të shpallur;

b) një jetëshkrim i përditësuar;

c) vetëdeklarim për mospasjen masë disiplinore në fuqi;

ç) vetëdeklarim për mosqenien në situatën e papajtueshmërisë ambientale, sipas përcaktimeve të pikës 3, të nenit 8, të ligjit për statusin;

d) një platformë personale e qëllimeve dhe objektivave që kandidati propozon të ndjekë, në rast se ngrihet në detyrë si drejtues. Ky dokument duhet të jetë punë origjinale e kandidatit dhe nuk duhet të kalojë 15 faqe, në llojin e shkrimit *Times New Roman*, madhësia 12, me një njësi hapësirë mes rreshtave.

dh) platforma e kandidatit duhet të përmbajë ndër të tjera:

i. plan të detajuar mbi mënyrën e ushtrimit të kompetencave të drejtuesit. Kandidati duhet të japë një qëndrim mbi mënyrën se si mund të realizohen në mënyrën më të efektshme të mundshme kompetencat e drejtuesit të prokurorisë në fazën e hetimit, por pa cenuar pavarësinë e prokurorit të çështjes;

ii. një plan të besueshëm e të detajuar për të drejtuar zyrën, për të zhvilluar funksionimin dhe efektivitetin e saj;

iii. plan i besueshëm në lidhje me mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të zyrës së prokurorisë, për veprimtarinë administrative, që lidhen me ushtrimin e ndjekjes penale;

iv. vlerësimi i situatës së zyrës së prokurorisë përkatëse gjatë katërvjeçarit të fundit dhe vizioni i tij, në lidhje me sfidat kryesore me të cilat përballlet kjo zyrë, duke listuar hapat që duhet të ndërmerren për të përballuar këto sfida dhe arsyet e përzgjedhjes së tij;

v. hapat të cilët duhet të ndërmerren për të rritur nivelin e besueshmërisë së publikut në sistemin e prokurorisë;



vi. hapat dhe planifikimet që duhet të kryhen për të evidentuar nëse në sistemin e Prokurorisë respektohen të drejtat dhe liritë themelore të njeriut;

e) çdo dokument tjetër që do të kërkohej nëpërmjet thirrjes apo që e gjykon të arsyeshëm kandidati.

3. Shprehja e interesit dhe të gjitha dokumentet e kërkuara duhet t'i dorëzohen Këshillit deri në datën dhe orën e përfundimit të afatit, në zyrën e protokollit të Këshillit, në adresën postare ose në adresën elektronike të shënuar në thirrjen për paraqitjen e shprehjeve të interesit.

Neni 7

E drejta për t'u riemëruar e drejtuesit në detyrë

Mandati i kryetarit është trevjeçar, me të drejtë riemërimi vetëm një herë. Drejtuesi në detyrë, mund të kandidojë për t'u riemëruar drejtues i prokurorisë, nëse plotëson kushtet ligjore si më poshtë:

a) të kandidojë për një mandat të dytë, jo më vonë se 6 muaj para mbarimit të mandatit të tij të parë;

b) të jetë vlerësuar gjatë veprimtarisë si kryetar dhe magjistrat, të paktën "Shumë mirë".

Neni 8

Kushtet për kandidim për ngritjen në detyrë në pozicionin e drejtuesit të prokurorisë

Në procedurën e ngritjes në detyrë në pozicionin e drejtuesit në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm, mund të kandidojnë prokurorët që përmbushin kushte ligjore si më poshtë:

a) të jetë prokuror i Republikës së Shqipërisë;

b) të mos ketë masë disiplinore në fuqi;

c) të mos ketë qenë anëtar i Këshillit në tri vitet e fundit;

ç) të ketë ushtruar funksionin jo më pak se 7 (shtatë) vjet, gjatë së cilës periudhë, të paktën 4 vjet në të njëjtën shkallë, duke përfshirë edhe përvojën si magjistrat i komanduar;

d) Në momentin e shpalljes të jetë prokuror i prokurorisë, pranë së cilës ndodhet pozicioni i lirë i drejtuesit. Ky kusht nuk zbatohet në rast se në atë prokurori, dy muaj para dhe deri në tre muaj pas mbarimit të mandatit të drejtuesit, ka

pozicione që bëhen të lira në mënyrë të përhershme;

dh) të jetë kandidimi i tij i parë në pozicionin e drejtuesit të asaj prokurorie.

KREU III KUALIFIKIMI

Neni 9

Kualifikimi i kandidatëve

1. Jo më vonë se 7 ditë, nga përfundimi i afatit të kandidimit, Komisioni kryen një vlerësim paraprak të të gjithë prokurorëve të interesuar, për të përcaktuar nëse ata i plotësojnë kushtet kualifikuese të parashikuara nga gerrat "a" dhe "b", e nenit 7 ose gerrat "a", "b" dhe "c", të nenit 8 të kësaj rregulloreje. Pas kësaj faze, procedohet me verifikimin e plotësimit të kriterëve të përvojës profesionale minimale, parashikuar nga gerrat "ç", "d" dhe "dh", të nenit 8 të kësaj rregulloreje. Në rast se prokurori i interesuar nuk plotëson një nga kriteret kualifikuese, nga ana e Komisionit nuk vijohet me verifikimin e kushteve të përvojës minimale profesionale.

2. Kryetari i Komisionit raporton në mbledhjen e radhës së Këshillit, rezultatet e vlerësimit paraprak të kandidatëve.

3. Këshilli miraton listën me emrat e kandidatëve që plotësojnë kushtet sipas pikës 1 të këtij neni.

4. Për kandidatët që plotësojnë kushtet ligjore, sipas pikës 1 të këtij neni, Këshilli merr vendim për fillimin e procedurës së verifikimit dhe Komisioni i Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale kryen procedurat për verifikimin e plotë të pasurisë dhe figurës, sipas parashikimeve të pikave 2 deri në 7, të nenit 32, të ligjit për statusin dhe vendimit nr. 171, datë 27.9.2019, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, "Rregullore për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin, emërimin si magjistrat dhe caktimin në pozicion të kandidatëve për prokurorë, si dhe për zhvillimin e karrierës së prokurorëve".

5. Pas përfundimit të verifikimeve, sipas pikës 4 të këtij neni, Këshilli vendos lejimin e kandidatit prokuror dhe vijimin e procedurës së mëtejshme të ngritjes në detyrë ose ndalimin e



kandidatit prokuror dhe përjashtimin e tij nga procedura e ngritjes në detyrë¹.

SEKSIONI III HAPAT, KRITERET DHE PËRPARËSITË NË RENDITJEN E KANDIDATËVE

KREU I RREGULLA TË PËRGJITHSHME

Neni 10

Hapat, kriteret dhe përparësitë për renditjen e kandidatëve për ngritjen në detyrë në pozicionin e drejtuesit

1. Procesi i renditjes së kandidatëve për ngritjen në detyrë në pozicionin e drejtuesit të prokurorisë zbatohet nëpërmjet kryerjes së hapave të mëposhtme:

a) zbatohet fillimisht kriteri i nivelit të dy vlerësimeve të fundit etike dhe profesionale;

b) në rast të kandidatëve me nivele të barabarta vlerësimi, sipas shkronjës “a”, zbatohet skema e pikëzimit për renditjen e tyre, në bazë të kriterëve përbërës të vlerësimit të posaçëm, sipas aneksit nr. 1;

c) në rast se edhe pas vlerësimit të bërë, sipas germës “b”, ka më shumë se një kandidat me pikë të barabarta, zbatohet kriteri i përvojës profesionale specifike, që kërkohet për pozicionin e lirë;

ç) në rast se edhe pas vlerësimit të bërë, sipas germës “c”, ka më shumë se një kandidat me nivel të barabartë vlerësimi, zbatohet kriteri i vjetërsisë si magjistrat.

2. Hapi pasues i renditjes ndiqet vetëm nëse në përfundim të hapat paraardhës nuk arrihet të bëhet renditja e kandidatëve me rezultate të njëjta më të larta.

¹ Shiko germën “c”, pika 8, seksioni “Ç”, kreu VI, të vendimit nr. 171, datë 27.9.2019, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, “Rregullore për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjorë për rekrutimin, emërimin si magjistrat dhe caktimin në pozicion të kandidatëve për prokurorë, si dhe për zhvillimin e karrierës së prokurorëve”.

KREU II HAPI I PARË, KRITERET DHE PËRPARËSITË E RENDITJES SË KANDIDATËVE

Neni 11

Faza 1: Përparësitë e renditjes sipas dy vlerësimeve të fundit etike profesionale

1. Renditja e kandidatëve bazohet në vlerësimin krahasues të niveleve të dy vlerësimeve të fundit etike dhe profesionale. Kandidati me nivelet më të larta të vlerësimit etik dhe profesional, renditet më lart.

2. Në rastin e kandidatit të komanduar në një institucion brenda sistemit të drejtësisë, niveli i vlerësimit etik dhe profesional nga ky institucion, njihet si nivel vlerësimi edhe në kuptim të këtij vendimi, duke mbajtur në konsideratë, në këtë rast, nivelet e vlerësimit, sipas ligjit të posaçëm të institucionit të sistemit të drejtësisë dhe nivelet e vlerësimit, sipas sistemit të kohës për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarëve.

3. Në rastin kur kandidatit të komanduar nuk i është bërë vlerësim etik dhe profesional nga institucioni i sistemit të drejtësisë, atëherë ai vlerësohet për aftësitë profesionale si kandidati jogjyqtar në Gjykatën e Lartë, sipas parashikimeve të nenit 49, të ligjit për statusin.

Neni 12

Faza 2: Përparësitë e renditjes sipas skemës së pikëzimit

1. Në rast se edhe pas zbatimit të përparësive, sipas pikës 1 të këtij neni, ka më shumë se një kandidat me nivele të barabarta të dy vlerësimeve të fundit, për renditjen e tyre zbatohet skema e pikëzimit, në bazë të kriterëve përbërës të vlerësimit të posaçëm, sipas kësaj rregulloreje dhe aneksit 1.

2. Skema e pikëzimit zbatohet veçmas për secilën procedurë ngritjeje në detyrë në pozicion drejtuesi, për të cilën kandidatët po konkurrojnë.

3. Kriteret e skemës së pikëzimit përfshihen në aneksin 1.

4. Skema e pikëzimit, në përputhje me pikën 3 të këtij neni, bazohet në analizën krahasuese sasior dhe cilësor të nivelit të kriterëve përbërës të vlerësimit të posaçëm, sipas aneksit 1.



Neni 13

Kriteret përbërës të vlerësimit të posaçëm

1. Vlerësimi etik dhe profesional përbëhet nga pesë kriteret e mëposhtëm:

- a) “aftësitë e organizimit në punë dhe drejtim”;
- b) “aftësitë në hartimin dhe miratimin e akteve administrative dhe ligjore”;
- c) “aftësitë në ndërveprimin me medien”;
- ç) “aftësi të tjera”;
- d) “vizioni për ngritjen e një zyre prokurorie funksionale dhe efektive”.

2. Aftësitë e organizimit në punë dhe drejtimin e një zyre prokurorie, përbëhen nga:

- a) eksperiencë e mëparshme si drejtues në sistemin e prokurorisë;
- b) ngarkesë mbi mesatare për tri vitet e fundit të ushtrimit të funksionit;
- c) eksperiencë e mëparshme në pozicione drejtuese në administratën publike ose të drejtësisë, ose përvoja si anëtar i Këshillit;
- ç) Përvoja në skemën e delegimit ose si inspektorit në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

3. Aftësitë në hartimin dhe miratimin e akteve administrative dhe ligjore përbëhen nga:

- a) hartues kryesor ose bashkëhartues i akteve ligjore;
- b) hartues kryesor ose bashkëhartues i akteve administrative;
- c) pjesëmarrje dhe këshillim në grupet e punës për hartimin e akteve ligjore;
- ç) pjesëmarrje dhe këshillim në grupet e punës për hartimin e akteve administrative.

4. Aftësitë në ndërveprim me medien përbëhen nga:

- a) eksperiencë e mëparshme si prokuror i caktuar për çështjet e shtypit;
- b) pjesëmarrje në çështje penale të cilat kanë marrë vëmendje të lartë publike;
- c) trajnime afatgjata jo më pak se dy javë në fushën e marrëdhënieve me publikun;
- ç) trajnime afatshkurtra në fushën e marrëdhënieve me publikun.

5. Aftësitë të tjera përbëhen nga:

- a) aktivizim në struktura organizative dhe modele të ndryshme të drejtimit;
- b) aktivizim si magjistrat udhëheqës për kandidatë prokurorë, si ekspert apo lehtësues në Shkollën e Magjistraturës;

c) mbajtja e gradës shkencore ose titujve akademik, studime dhe specializime afatgjata, zotërim i gjuhëve të huaja;

ç) aftësi e provuar për të punuar në grup dhe në mjedise multidisiplinare dhe/ose multikulturore.

6. Vizioni për ndërtimin e një zyre prokurorie funksionale dhe efektive përbëhet nga:

a) plan i detajuar mbi mënyrën e ushtrimit të kompetencave të drejtuesit, gjatë ushtrimit të ndjekjes penale;

b) plan i besueshëm në lidhje me mënyrën e organizimit dhe funksionimit së zyrës së prokurorisë, për veprimtarinë administrative që lidhet me ushtrimin e ndjekjes penale;

c) plan i besueshëm dhe shumë i detajuar për të drejtuar zyrën, për të zhvilluar funksionimin dhe efektivitetin e saj në aspektin administrativ dhe përfaqësimi në marrëdhënie me të tretët.

Neni 14

Vlerësimi i posaçëm

1. Vlerësimi i aftësive organizuese në punë dhe drejtim do të bazohet në analizën krahasuese, të eksperiencave që ka çdo kandidat në ushtrimin e funksioneve drejtuese, si, p.sh., drejtues, zëvendës drejtues, drejtues seksioni i një zyre prokurorie, drejtor drejtorie apo departamenti në Prokurorinë e Përgjithshme; ngarkesa e kandidatit në raport me ngarkesën mesatare të zyrës së prokurorisë ku ka ushtruar funksionin, çdo lloj eksperience si drejtues jashtë sistemit të prokurorisë, përvoja si anëtar i KLP-së, i skemës së delegimit dhe si inspektor i ILD-së.

2. Vlerësimi i aftësive në hartimin dhe miratimin e akteve administrative do të bazohet në të dhëna të dokumentuara ku vlerësohet angazhimi dhe roli në veprimtarinë konkrete.

3. Vlerësimi i aftësive në ndërveprim me medien do të bazohet në të dhëna të dokumentuara për eksperiencën të kandidatit në çështjet e shtypit, çështje që kanë marrë vëmendje të lartë publike, trajnime afatgjatë dhe afatshkurtër në fushën e marrëdhënieve me publikun.

4. Vlerësimi i aftësive të tjera do të bazohet në të dhëna të dokumentuara për aktivizimin e kandidatit në struktura të ndryshme organizative si anëtar i KED-së, anëtar i Bordit Drejtues të Shkollës së Magjistraturës, eksperiencën si magjistrat udhëheqës për kandidatë prokurorë, si ekspert apo



lehtësues në Shkollën e Magjistraturës, mbajtja e gradës shkencore ose titujve akademikë, studime dhe specializime afatgjatë, zotërim i gjuhëve të huaja, eksperiencë e punës në grup dhe në mjedise multidisiplinore dhe/ose multikulturore.

5. Vlerësimi i planit për ndërtimin e një zyre prokurorie funksionale dhe efektive bazohet në platformën e paraqitur nga kandidati, duke i kushtuar rëndësi, nivelit të kuptimit që kandidati ka për rolin e tij si drejtues prokurorie, vizionin e kandidatit në lidhje me sfidat kryesore me të cilat përballlet zyra përkatëse e prokurorisë nga ana organizative dhe e çështjeve thelbësore të së drejtës, mendimet dhe sugjerimet e kandidatit për t'i adresuar këto sfida. Mbahet në konsideratë edhe gjuha e përdorur, struktura e fjalive qartësia dhe kuptueshmëria e tyre.

6. Kandidati, ka barrën për të sjellë dokumente që do të shërbejnë për vlerësimin e kriterëve të vlerësimit të posaçëm.

Neni 15

Niveli dhe pikëzimi

1. Në zbatim të kësaj rregulloreje, vlerësimi i posaçëm i kandidatëve do të bëhet me nivele vlerësimi dhe pikëzimi.

2. Për nevoja vlerësimi do të zbatohen tri nivele vlerësimi: i lartë, i mesëm dhe i ulët.

3. Kandidati do të ketë vlerësim të lartë për kriterin përkatës, nëse përmbush të paktën tri nga nënkriteret përkatëse; do të ketë vlerësim të mesëm, nëse përmbush dy nënkriterë dhe do të ketë vlerësim të ulët nëse përmbush një ose asnjë nënkriter.

4. Për nivelin e vlerësimit të lartë do të aplikohen nga 8 deri në 10 pikë, për nivelin e vlerësimit të mesëm do të aplikohen nga 4 deri në 7 pikë dhe për nivelin e vlerësimit të ulët do të aplikohen nga 0 deri në 3 pikë, sipas aneksit nr. 1.

Neni 16

Vlerësimi i kandidatëve

1. Komisioni bën vlerësimin e kandidatëve për katër kriteret e para, duke përjashtuar kriterin e pestë që ka të bëjë me vizionin dhe paraqet në Këshill listën e kandidatëve të radhitur sipas niveleve të vlerësimit.

2. Këshilli njofton për intervistë kandidatët dhe

pas intervistës bën vlerësimin e tyre me pikë për të pesta kriteret, duke vendosur përfundimisht për renditjen e kandidatëve.

3. Për kriterin e pestë që ka të bëjë me vizionin, pas intervistës me kandidatin do të vlerësohen me pikë tri nënkriterë. Përkatësisht do të vlerësohet deri në 4 pikë nënkriteri i parë, deri në 3 pikë nënkriteri i dytë dhe deri në 3 pikë nënkriteri i tretë. Ky kriter maksimalisht do të vlerësohet me 10 pikë, sipas aneksit nr. 1.

KREU III

HAPI I DYTË, KRITERET DHE PËRPARËSITË E RENDITJES SË KANDIDATËVE

Neni 17

Përvoja profesionale specifike

1. Nëse pas renditjes së kandidatëve, sipas kriterëve të vlerësimit të posaçëm profesional, ka dy ose më shumë kandidatë për të njëjtin pozicion të lirë që kanë pikë të barabarta deri në këtë fazë, Këshilli i rendit kandidatët sipas përvojës profesionale.

2. Përvoja profesionale specifike është treguesi që individualizon meritat e kandidatit, në varësi të kohëzgjatjes së përvojës së tij si drejtues në sistemin e prokurorisë.

KREU IV

HAPI I TRETË, KRITERET DHE PËRPARËSITË E RENDITJES SË KANDIDATËVE

Neni 18

Vjetërsia si magjistrat

1. Nëse pas renditjes së kandidatëve sipas përvojës specifike profesionale ka dy ose më shumë kandidatë me pikë të barabarta deri në këtë fazë, Këshilli i rendit kandidatët sipas vjetërsisë si magjistrat.

2. Treguesi i vjetërsisë vlerësohet me radhë sipas kriterëve të mëposhtme:

- a) vjetërsia në detyrën e prokurorit;
- b) vjetërsia në detyrën e gjyqtarit.



SEKSIONI IV
PROCEDURA E PËRZGJEDHJES PËR
NGRITJEN NË DETYRË NË POZICION
DREJTUESI

KREU I
FILLIMI I PROCEDURËS SË
PËRZGJEDHJES PËR NGRITJEN NË
DETYRË NË POZICION DREJTUESI

Neni 19

Fillimi i procedurës dhe caktimi i relatorit

1. Këshilli, jo më vonë se 7 ditë nga vendimi për kualifikimin e kandidatëve, vendos fillimin e procedurës së përzgjedhjes për ngritjen në detyrë, si dhe cakton nëpërmjet shortit, relatorin për atë procedurë.

2. Për arsye të motivuara, Këshilli mund të vendosë përjashtimin e çdo anëtari të Komisionit nga shorti.

3. Anëtari i Komisionit dhe/ose çdo anëtar tjetër i Këshillit, në çdo kohë, kur merr dijeni për ekzistencën e një konflikti interesi është i detyruar të deklarojë natyrën e konfliktit të interesit ose pengesës dhe të heqë dorë nga pjesëmarrja në procedurën e përzgjedhjes për ngritjen në detyrë për atë pozicion të lirë.

4. Anëtari i Komisionit dhe/ose çdo anëtar tjetër i Këshillit, që më herët ka dhënë dorëheqjen ose është përjashtuar në një procedurë verifikimi të kriterëve ligjore të kandidimit, për një nga kandidatët që konkurren për pozicionin e lirë për të cilin zhvillohet procedura e përzgjedhjes për ngritjen në detyrë, nuk mund të marrë pjesë në këtë procedurë në rast se konflikti i interesit ose pengesa ligjore për shkak të të cilit ai ka dhënë dorëheqjen ose është përjashtuar, vijon të ekzistojë.

Neni 20

Të drejtat e kandidatit

1. Kandidati njoftohet për relatorin brenda tri ditëve nga e nesërmja e caktimit të tij.

2. Kandidati ka të drejtë të kërkojë përjashtimin e relatorit jo më vonë se 3 ditë nga marrja dijeni e shkakut të përjashtimit, duke shoqëruar kërkesën, kur është rasti, me aktet provuese të shkakut të përjashtimit. Këtë të drejtë kandidati e ka edhe ndaj çdo anëtari tjetër të Këshillit.

3. Këshilli vendos për kërkesën e kandidatit për përjashtimin e relatorit të çështjes dhe/ose të çdo anëtari tjetër të Këshillit, jo më vonë se 7 ditë nga paraqitja e saj.

4. Kandidati ka të drejtë që, në çdo fazë të procedurës së përzgjedhjes për ngritjen në detyrë, me kërkesë, të njihet me dokumentet e dosjes së tij, si edhe të marrë kopje të tyre, sipas rregullave të Kodit të Procedurave Administrative.

5. Kandidati, që ka qenë i komanduar në një institucion brenda sistemit të drejtësisë dhe ky i fundit nuk ka bërë vlerësimin e tij etik dhe profesional, ka të drejtë që, në momentin e aplikimit për ngritjen në detyrë, të kërkojë bërjen e këtij vlerësimi nga Këshilli, sipas rregullave përkatëse të vlerësimit.

6. Kandidati, vlerësimi i fundit i të cilit është realizuar para më shumë se dy viteve, mbi kërkesën e tij, mund të vlerësohet me procedurë të përshpejtuar, sipas nenit 97 të ligjit për statusin.

7. Kryesisht apo mbi kërkesën e Këshillit, kandidati ka të drejtë të paraqesë shpjegime me shkrim për fakte, rrethana apo çështje ligjore që lidhen me kriteret e renditjes, si dhe të depozitojë, kur është rasti, dokumente shkresore në mbështetje të këtyre shpjegimeve.

8. Kandidati ka të drejtë të tërhiqet nga kandidimi derisa nuk ka përfunduar procedura e përzgjedhjes për ngritjen në detyrë, duke depozituar kërkesën e tij me shkrim. Mbi këtë kërkesë, me propozim të relatorit të çështjes, Këshilli vendos përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë për këtë kandidat. Vendimi i Këshillit i njoftohet kandidatit dhe bëhet publik në faqen e tij zyrtare.

Neni 21

Njoftimet

1. Njoftimet dhe kërkesat e Këshillit drejtuar kandidatit dhe anasjelltas, si rregull bëhen në rrugë elektronike nga relatori. Ato konsiderohen të marra ditën e nesërme të dërgimit në rrugë elektronike.

2. Adresa elektronike e Këshillit i bëhet e ditur kandidatit me njoftimin e fillimit të procedurës së përzgjedhjes për ngritjen në detyrë.

3. Adresa elektronike e kandidatit konsiderohet adresa e tij zyrtare, por ai mund të zgjedhë një adresë tjetër elektronike, duke ia bërë atë të ditur në kohë Këshillit. Kandidati merr masa për aksesueshmërinë e adresës së tij elektronike.



KREU II
FAZAT E PROCEDURËS SË
PËRZGJEDHJES PËR NGRITJEN NË
DETYRË

Neni 22

**Fazat e procedurës së përzgjedhjes për
ngritjen në detyrë në pozicion drejtuesi**

Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve për ngritjen në detyrë realizohet sipas fazave të mëposhtme, në varësi të ecures së përzgjedhjes:

a) veprimet procedurale dhe verifikuese të relatorit;

b) shqyrtimi dhe miratimi nga Komisioni i projektvendimit të renditjes së kandidatëve ose i projektvendimit të propozimit për përcaktimin e nivele për vlerësimin e kritereve, në kuadër të vlerësimit të posaçëm;

c) shqyrtimi dhe miratimi nga Këshilli i projektvendimit të renditjes së kandidatëve ose i projektvendimit të propozimit për përcaktimin e niveleve për vlerësimin e kritereve, në kuadër të vlerësimit të posaçëm:

i. nëse për renditjen e kandidatëve është kaluar në fazën e vlerësimit të posaçëm, Këshilli, pas miratimit të niveleve të vlerësimit, vijon me intervistimin e kandidatëve dhe pikëzimin sipas kritereve të vlerësimit të posaçëm;

ii. shqyrtimi dhe miratimi nga Këshilli i projektvendimit përfundimtar të renditjes së kandidatëve.

Neni 23

**Veprimet procedurale dhe verifikuese
të relatorit**

1. Relatori i çështjes ndjek dhe kryen të gjitha veprimet procedurale, në lidhje me:

a) komunikimin me kandidatët sa u përket paraqitjes, pranimi dhe plotësimit të dokumenteve të nevojshme për vlerësimin, pikëzimin dhe renditjen e tyre sipas përcaktimeve të ligjit dhe këtij vendimi;

b) përgatitjen e dokumentacionit dhe paraqitjen e projektvendimeve të nevojshme për shqyrtim nga Komisioni dhe Këshilli lidhur me procedurën e përzgjedhjes së kandidatëve.

2. Relatori kujdeset për zhvillimin e procedurës së përzgjedhjes së kandidatëve për ngritjen në

detyrë në pozicion drejtuesi dhe, në veçanti, për:

a) administrimin dhe shqyrtimin e dokumentacionit të kandidatëve, që gjendet në dosjet e tyre personale;

b) administrimin e dokumentacionit të paraqitur nga kandidati për procedurën e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve;

c) përgatitjen dhe paraqitjen për shqyrtim të relacionit që përmban përshkrimin e procedurave të ndjekura gjatë veprimeve përgatitore, të dokumenteve dhe përmbledhjen faktike të tyre për qëllime të vlerësimit dhe pikëzimit të kandidatit, si edhe kopje të këtyre dokumenteve bashkëlidhur relacionit;

ç) përgatitjen dhe paraqitjen për shqyrtim të projektvendimit paraprak të renditjes së kandidatëve ose projektvendimin paraprak të propozimit për përcaktimin e niveleve të vlerësimit, në kuadër të vlerësimit të posaçëm;

d) koordinimin me kryetarin e Komisionit për përgatitjen e mbledhjes së Komisionit;

dh) koordinimin me kryetarin e Këshillit për përgatitjen e mbledhjes plenare të Këshillit;

e) Njoftimet për kandidatët.

3. Në ushtrimin e përgjegjësisë së tij, relatori ndihmohet nga Njësia Mbështetëse e Komisioneve dhe personeli administrativ i Këshillit, të cilët kanë detyrimin të ndjekin procedurat, të kryejnë veprimet dhe të përgatisin aktet përkatëse, sipas udhëzimeve të relatorit.

4. Me qëllim vlerësimin e kritereve të vlerësimit të posaçëm, të parashikuara nga pikat 2, 3, 4 dhe 5, të nenit 13, të kësaj rregulloreje, relatori kërkon nga çdo kandidat, paraqitjen e kopjes së dokumenteve, që do të shërbejnë për vlerësimin e këtyre kritereve. Kandidatët mund të paraqesin çdo akt, i cili shërben për individualizimin e meritave të tyre.

5. Njoftimi për paraqitjen e akteve, sipas pikës 4 të këtij neni, bëhet nëpërmjet postës elektronike dhe kandidati, brenda 7 ditëve nga e nesërmja e njoftimit, duhet të marrë masa për depozitimin e akteve pranë protokollit të Këshillit. Nëse kandidati nuk depoziton aktet, brenda afatit të caktuar pa shkaqe të justifikuara, do të konsiderohet se kandidati është tërhequr nga gara.

6. Nëse nga shqyrtimi i dokumentacionit të dosjes personale ose i dokumentacionit të paraqitur nga kandidati, relatori i çështjes konstaton dhe vlerëson se është i paplotë, ose mungon, njofton menjëherë kandidatin, duke i caktuar një afat jo më



shumë se 5 ditë për dorëzimin e tij. Kur i vlerëson të justifikuarat motivet e paraqitura nga kandidati për mospërmbushjen e detyrimit për dorëzimin e dokumentacionit të kërkuar, brenda afatit 5-ditor, relatori i çështjes i cakton një afat të ri të arsyeshëm.

7. Kur është rasti, relatori mund të kërkojë nga subjekte publike dhe private, brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, sqarime, të dhëna ose kopje të dokumenteve të konfirmuara zyrtarisht prej tyre, si dhe çdo informacion shtesë që e vlerëson të rëndësishëm për vlerësimin e posaçëm.

8. Për renditjen e kandidatëve, relatori zbaton parashikimet e seksionit III të kësaj rregulloreje, në varësi të hapit apo të fazës që po shqyrtohet. Nëse lind e nevojshme, relatori nis procedurën për përcaktimin e niveleve për vlerësimin e kritereve të posaçëm, sipas aneksit 1 të kësaj rregulloreje, vetëm për kandidatët të cilët kanë rezultuar me nivele të barabarta vlerësimi. Përcaktimi i niveleve për secilin kriter, bëhet sipas parashikimeve të nenit 15 të kësaj rregulloreje.

9. Në përfundim të veprimeve për të gjithë kandidatët, relatori njofton kryetarin e Komisionit dhe i paraqet për shqyrtim Komisionit relacionin ku propozohet renditja e kandidatëve, ose nivelet për vlerësimin e kritereve të posaçme, sipas aneksit 1 dhe dokumentacionin e përgatitur për procedurën e përzgjedhjes për ngritjen në detyrë.

Neni 24

Shqyrtimi dhe miratimi nga Komisioni i projektaktit të relatorit

1. Kryetari i Komisionit, menjëherë pas njoftimit nga relatori për çështjen e përgatitur për shqyrtim, thërret mbledhjen e Komisionit, duke marrë masa për njohjen e anëtarëve me materialet e çështjes.

2. Në mbledhjen e Komisionit, relatori paraqet përmbledhjen e veprimeve kryera, si edhe të fakteve që kanë rezultuar gjatë zhvillimit të procedurës së renditjes për ngritjen në detyrë të kandidatëve.

3. Komisioni, pasi dëgjon relatorin, nëse vlerëson që procedura e renditjes për ngritjen në detyrë dhe dokumentacioni përkatës i kandidatëve është i paplotë, i kërkon relatorit plotësimin e procedurës apo të dokumentacionit të nevojshëm.

Në rast të kundërt, Komisioni vendos për kalimin e çështjes për shqyrtim në Këshill.

4. Nëse anëtarët e komisionit, nuk janë dakord me renditjen e bërë apo nivelet e përcaktuara për vlerësimin e kritereve, në kuadër të vlerësimit të posaçëm nga relatori, shprehin qëndrimin e tyre në një akt, i cili i bashkëlidhet relacionit. Në akt duhet të saktësohet pikat për të cilat ka vlerësim ndryshe duke argumentuar dhe vlerësimin përkatës.

Neni 25

Shqyrtimi nga Këshilli i projektaktit të Komisionit

1. Kryetari i Këshillit, menjëherë pas njoftimit nga relatori për çështjen e përgatitur për shqyrtim, thërret mbledhjen e Këshillit.

2. Dita dhe koha e zhvillimit të mbledhjes së Këshillit, së bashku me relacionin e përgatitur nga relatori, u njoftohet kandidatëve.

3. Në mbledhjen e Këshillit, kryetari i Këshillit fton relatorin të paraqesë përmbledhjen e veprimeve procedurale të kryera, si edhe të fakteve që kanë rezultuar gjatë zhvillimit të procedurës së përzgjedhjes për ngritjen në detyrë.

4. Anëtarët e Këshillit mund t'i drejtojnë relatorit pyetje dhe t'i kërkojnë shpjegime të natyrës sqaruese.

5. Pas këtij hapi, Këshilli kalon në fazën e diskutimeve dhe vendos:

a) nëse veprimet procedurale dhe verifikuese të relatorit, si dhe dokumentacioni për renditjen e kandidatëve janë të plotë;

b) miratimin e renditjes së kandidatëve; ose

c) miratimin e shkallëve për vlerësimin e kritereve, në kuadër të vlerësimit të posaçëm, caktimin e datës së intervistës, pikëzimin nga anëtarët e Këshillit dhe miratimin e renditjes së kandidatëve.

6. Nëse gjatë diskutimeve Këshilli vlerëson dhe vendos që veprimet procedurale të kryera nga relatori dhe/ose dokumentacioni i nevojshëm për renditjen e kandidatëve nuk është i plotë, atëherë cakton një seancë tjetër për shqyrtimin e çështjes. Në këtë rast, Këshilli ngarkon relatorin të marrë masa për plotësimin sa më parë të mangësive të evidentuara. Në seancën e radhës, që caktohet jo më vonë se 7 ditë nga njoftimi i relatorit, ky i fundit paraqet para Këshillit aktet shtesë. Në këtë rast, Këshilli vijon bisedimet dhe vendos për çështjet e



renditura në pikën 5 të këtij neni.

7. Në përfundim të diskutimeve, Këshilli voton për renditjen e kandidatëve ose përcaktimin e niveleve për vlerësimin e kriterëve, në kuadër të vlerësimit të posaçëm.

8. Nëse për renditjen e kandidatëve është kaluar në fazën e vlerësimit të posaçëm, Këshilli, para se të procedojë me pikëzimin, cakton datën dhe orën e intervistës për kandidatët.

9. Kandidatët njoftohen për vendin, ditën dhe kohën e paraqitjes për intervistë, në një seancë dëgjimore, në mbledhjen e Këshillit. Njoftimi përmban edhe udhëzimet lidhur me natyrën dhe kohëzgjatjen e intervistës.

10. Në seancën dëgjimore Këshilli pyet kandidatët, për të marrë informacion mbi platformën e paraqitur nga ana e tyre.

11. Pas orientimit për mënyrën e zhvillimit të intervistës dhe kohëzgjatjen e saj, kandidati i thirrur për intervistë ftohet për të parashtruar platformën e tij dhe arsyet e kandidimit dhe objektivave që synon të ndjekë nëse ngrihet në detyrë në pozicion drejtuesi. Intervista vijon me pyetje të anëtarëve të Këshillit dhe përgjigjet e kandidatit.

12. Këshilli pyet kandidatët, me qëllim për të marrë të dhëna që i shërbejnë për vlerësimin e kriterëve të parashikuara nga neni 12 i kësaj rregulloreje dhe jo më vonë se një javë nga data e intervistës mbledhet për të bërë pikëzimin.

13. Ky vlerësim dhe pikëzimi përkatës mbështetet në dokumentacionin e paraqitur dhe, kur është rasti, edhe në intervistat e realizuara me kandidatët.

14. Në përfundim të procedurës së pikëzimit, Këshilli voton për renditjen e kandidatëve, sipas totalit të pikëve të grumbulluara sipas kriterëve të vlerësimit të posaçëm.

Neni 26

Veprimet procedurale të Këshillit dhe Komisionit për renditjen e kandidatëve, sipas kriterëve të përvojës profesionale dhe vjetërsisë si magjistrat

1. Nëse pas renditjes së kandidatëve, sipas kriterëve të vlerësimit të posaçëm, ka dy ose më shumë kandidatë për të njëjtin pozicion të lirë që kanë pikë të barabarta deri në këtë fazë, Këshilli, kalon çështjen për shqyrtim në Komision, me qëllim administrimin e dokumentacionit,

përgatitjen e relacionit dhe të projektvendimit për renditjen e kandidatëve, sipas kriterëve të përvojës profesionale dhe vjetërsisë si magjistrat.

2. Në këtë rast zbatohen për aq sa është e mundur rregullat e parashikuara nga nenet 23, 24 dhe 25 të kësaj rregulloreje.

**KREU III
VENDIMI I RENDITJES**

Neni 27

Vendimi për renditjen e kandidatëve dhe e drejta e ankimit

1. Vendimi i Këshillit për renditjen e kandidatëve arsyetohet nga relatori jo më vonë se 10 ditë nga miratimi i tij. Vendimi nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e Këshillit që kanë marrë pjesë në votim.

2. Vendimi i arsyetuar i Këshillit iu njoftohet kandidatëve.

3. Kundër vendimit të Këshillit mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 5 ditëve nga dita e njoftimit të vendimit. Gjykata merr vendimin brenda dy javëve nga dita e ankimit. Vendimi i gjykatës është i formës së prerë.

4. Në rastin kur Gjykata Administrative e Apelit pranon ankimin e kandidatit/kandidatëve dhe shfuqizon vendimin, Këshilli, brenda dy javëve nga njoftimi i vendimit gjyqësor, rishikon vendimin e tij në masën e nevojshme për zbatimin e vendimmarrjes së gjykatës.

5. Vendimi i formës së prerë për renditjen e kandidatëve, bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit.

**KREU IV
VENDIMI I NGRITJES NË DETYRË**

Neni 28

Vendimi për ngritjen në detyrë në pozicion drejtuesi

1. Jo më vonë se 7 ditë nga marrja formë të prerë të vendimit për renditjen e kandidatëve për ngritjen në detyrë, Këshilli merr vendim për ngritjen në detyrë në atë pozicion të lirë të kandidatit të renditur më lart.

2. Vendimi i Këshillit për ngritjen në detyrë në pozicion drejtuesi u njoftohet kandidatit të ngritur



në detyrë, prokurorive përkatëse, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit.

3. Rregullat e parashikuara në nenin 41, pikat 2 deri në 4, të ligjit për statusin aplikohen për aq sa gjejnë zbatim.

KREU V PROCEDURA TË TJERA

Neni 29

Procedura e riemërimit në detyrë në pozicion drejtuesi

Gjatë procedurës për riemërimin në pozicion drejtuesit, të drejtuesit në detyrë, Komisioni dhe Këshilli zbatojnë për aq sa është e mundur rregullat e parashikuara nga kjo rregullore.

Neni 30

Ushtrimi i kompetencave të drejtuesit nga zëvendësdrejtuesi

1. Në rastet kur gjatë procedurave të konkurrimit për drejtues të prokurorisë nuk ka kandidatura për pozicionin e lirë, zëvendësdrejtuesi i zyrës së prokurorisë ushtron përkohësisht kompetencat e drejtuesit.

2. Në rastet kur në një zyrë prokurorie struktura është e plotësuar dhe kandidatët për vendin e lirë të drejtuesit nuk plotësojnë kriteret e përcaktuara nga ligji dhe rregullorja, zëvendësdrejtuesi i zyrës së prokurorisë ushtron përkohësisht kompetencat e drejtuesit.

3. Zëvendësdrejtuesi i zyrës së prokurorisë, ushtron përkohësisht funksionet e drejtuesit edhe në raste të tjera kur pozicioni i drejtuesit mbetet përkohësisht i lirë për arsye të tjera të parashikuara në ligj.

SEKSIONI V DISPOZITA PËR PERIUDHËN KALIMTARE

Neni 31

Dispozitë kalimtare

1. Vlerësimet e mëparshme etike dhe profesionale të kandidatit të realizuara përpara hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, konsiderohen të vlefshme për efekt të kësaj rregulloreje.

2. Konvertimi i niveleve të vlerësimit, sipas sistemeve të mëparshme të vlerësimit etik dhe profesional me ato sipas sistemit të vlerësimit në fuqi bëhet sipas tabelës së mëposhtme:

Niveli i vlerësimit sipas sistemeve të mëparshme të vlerësimit etik dhe profesional	Niveli i vlerësimit sipas sistemit të vlerësimit etik dhe profesional në fuqi (ligjit për statusin)
Nëse të gjitha kriteret e vlerësimit, sipas sistemit të mëparshëm janë “Shumë mirë”	Shkëlqyeshëm
Nëse një nga kriteret e vlerësimit sipas sistemit të mëparshëm është më pak se “Shumë mirë”	Shumë mirë
Mirë	Mirë
Mjaftueshëm	Mjaftueshëm
I pamjaftueshëm	I pamjaftueshëm

Neni 32

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi në ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.



ANEKS NR. 1

Nr.	Kriteret e vlerësimit	Elementet e vlerësimit të kriterëve	Po/jo	Shkalla e kualifikimit	Pikët maksimale
1	Aftësitë e organizimit në punë dhe drejtëm	Eksperiencë e mëparshme si drejtues në sistemin e prokurorisë			
		Ngarkesa mbi mesatare për tri vitet e fundit të ushtrimit të funksionit			
		Eksperiencë e mëparshme në pozicione drejtuese në administratën publike ose të drejtësisë, ose përvoja si anëtar i Këshillit			
		Përvoja në skemën e delegimit ose si inspektor pranë ILD-së			
2	Aftësitë në hartimin dhe miratimin e akteve administrative dhe ligjore	Hartues kryesor ose bashkëhartues i akteve ligjore			
		Hartues kryesor ose bashkëhartues i akteve administrative			
		Pjesëmarrje dhe këshillim në grupet e punës për hartimin e akteve ligjore			
		Pjesëmarrje dhe këshillim në grupet e punës për hartimin e akteve administrative			
3	Aftësitë në ndërveprim me median	Eksperiencë e mëparshme si prokuror i caktuar për çështjet e shtypit			
		Pjesëmarrje në çështje penale të cilat kanë marrë vëmendje të lartë publike			
		Trajnime afatgjata jo më pak se dy javë në fushën e marrëdhënieve me publikun			
		Trajnime afatshkurtra në fushën e marrëdhënieve me publikun			
4	Aftësi të tjera	Aktivizim në struktura organizative dhe modele të ndryshme të drejtimit			
		Aktivizim, si magjistrat udhëheqës për kandidatë prokurorë, si ekspert apo lehtësues në Shkollën e Magjistraturës			
		Mbajtja e gradës shkencore ose të titujve akademikë, studime dhe specializime afatgjata, zotërim i gjuhëve të huaja.			
		Aftësi e provuar për të punuar në grup dhe në mjedise multidisiplinare dhe/ose multikulturore			
Nr.	Kriteri i vlerësimit	Elementet e vlerësimit të kriterit	Pikët	Vlerësimi	Totali
5	Vizioni për ngritjen e një zyre prokurorie funksionale dhe efektive	Plan i detajuar mbi mënyrën e ushtrimit të kompetencave të drejtuesit, gjatë ushtrimit të ndjekjes penale	1-4		
		Plan i besueshëm në lidhje me mënyrën e organizimit dhe funksionimit së zyrës së prokurorisë, për veprimtarinë administrative që lidhet me ushtrimin e ndjekjes penale	1-3		
		Plan i besueshëm dhe shumë i detajuar për të drejtuar zyrën, për të zhvilluar funksionimin dhe efektivitetin e saj në aspektin administrativ dhe përfaqësimi në marrëdhënie me të tretët	1-3		
TOTALI I PIKËVE					

**NJOFTIM****Nr. 11140, datë 24.9.2020****MBI HYRJEN NË FUQI TË
MARRËVESHJES NDËRKOMBËTARE**

Konventa shumëpalëshe (MLI), për zbatimin e masave që lidhen me marrëveshjet tatimore për parandalimin e erozionit të bazës dhe transferimit të fitimeve (BEPS), depozituar më 22 shtator 2020, pranë Sekretariatit të Përgjithshëm të Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik, do të hyjë në fuqi më 1 janar 2021.

**DREJTOR I KABINETIT I MINISTRISË
PËR EVROPËN DHE PUNËT E JASHTME
Dastid Koreshi**

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2020

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 224 lekë